



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 80

Prishtinë, më 7.10.2016, në orën 23:20

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku Agim Ademaj dhe Pal Lekaj.

Munguan: Nezir Çoçaj, Valdete Bajrami dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha, OSCE.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 05/L-120 për Trepçën;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 05/L-120 për Trepçën;

Albulena Haxhiu, kryetare, në fjalën e saj tha se në Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik janë 21 amendamente, e ku 7 prej tyre janë të Grupit Vetëvendosje, që kishin për qëllim sovranizimin e Trepçës, nuk janë përkrahur.

Haxhiu, më tej bëri disa vërejtje në lidhje me disa amendamente, ku siç tha ajo, në disa raste iu referohen Ligjit për Shoqëri Tregtare, e në disa të tjera, iu referohen Ligjit për Ndërmarrje Publike. Kjo do të paraqesë probleme në implementimin e këtij ligji, potencoi Haxhiu dhe theksoi se meqë nuk janë përkrahur amendamentet e grupit parlamentar të Vetëvendosjes, do të abstenojë në votim.

Selvije Halimi paraqiti vërejtje në amendamentin 10, ku thuhet: “Statuti i Trepçës SHA propozohet nga Bordi mbikëqyrës, miratohet nga aksionaret pas aprovimit të Kuvendit të Kosovës”.

Halimi në vazhdim tha se aksionarët nuk mund të aprovojnë statutin pas aprovimit në Kuvend.

Pal Lekaj iu referua amendamentit 10, me ç’rast tha se nuk mund të jenë dy miratues dhe propozoi që të formulohet në këtë mënyrë: përpilohet nga Bordi menaxhues dhe i propozohet Kuvendit për miratim.

Rrustem Berisha sqaroi para anëtareve të Komisionit për Legjislacion se varianti si vijon: “Bordi mbikëqyrës të propozojë në statut, ndërsa të kalojë dhe të aprovohet në Kuvend”, besoj se është në rregull dhe theksoi se të gjithë ishim të pajtimit që këto amendamente të shkojnë në këtë formë.

Albulena Haxhiu, me këtë rast shtoi se sa i përket asaj që u tha nga deputeti Berisha se bëhet fjalë për fuqizimin e Kuvendit të Kosovës në rastin e miratimit të statutit është në rregull, problemi qëndron në formulimin “miratohet nga aksionarët, pas miratimit nga Kuvendi”, mendoj se kjo ligjërisht nuk është në rregull.

Armend Zemaj tha se me këtë ligj, Trepça po futet nën ombrellën institucionale. Duhet të procedohet në këtë formë, sepse dihet se ndërmarrjet publike nuk kanë dhënë rezultate të duhura në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në vazhdim Zemaj tha se me rimenaxhim përmes shoqërisë aksionare, mbi të gjitha me përgjegjësi të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, ndërsa sa i përket amendamenteve të propozuara nga Vetëvendosja, ato janë të njëjta, përveç disa lëvizjeve të ndonjë fjalie përbrenda amendamentit. Që të jetë më e qartë për opinionin, Zemaj kërkoi nga kryetarja e komisionit Albulena Haxhiu, që të kërkojë sqarim nga kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik se çka është menduar kur është përmendur “Bordi mbikëqyrës” dhe pse duhet përmendur edhe aksionaret në amendamentin e lartcekur.

Agim Aliu bëri vërejtje në amendamentin 19, ku tha se është i paqartë dhe nuk është i shkruar mirë. Aliu propozoi që aty ku thuhet të drejtat e Kosovës të shtohet, të drejtat e Republikës së Kosovës.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash dhe një abstenim(Albulena Haxhiu) vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë :

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-120 për Trepçën dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Të ndryshme.

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu